



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AA.nr.19/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Nenad Llaziq dhe Rrustem Thaqi, anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj V. K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej KGJK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së gjyqtarit V. K., paraqitur kundër vendimit Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr....., datë 29.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë, ankesa e V. K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, e paraqitur, kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr....., datë 29.03.2024.

A r s y e t i m

Me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr....., datë 29.03.2024, në pikën I, të dispozitivit ishte vendosur që V. K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.15, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 4, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar. Në pikën 2 të dispozitivit të këtij vendimi ishte vendosur që për shkeljen disiplinore të përcaktuar në paragrafin I të këtij vendimi, gjyqtarit V. K. i shqiptohet sanksioni disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës për tridhjetë (30%) për periudhën kohore për gjashtë (6) muaj.

Kundër këtij vendimi, gjyqtari V. K., në afat ka paraqitur ankesë, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në lidhje me sanksionin disiplinor, duke pohuar se sanksioni disiplinor

është shqiptuar pa të drejtë ligjore dhe nën ndikimin e opinionit publik dhe ka propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës, ta prish vendimin e KGJK-së dhe ta liroi nga përgjegjësia, paraqitësin e ankesës.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në përgjigje ndaj ankesës së gjyqtarit, pretendon se ankesa është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, sepse janë zbatuar në tërësi dispozitat e Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, sa i përket procedurës dhe kualifikimit të shkeljes, andaj i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzoi ankesën si të pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të vendimit të atakuar në kuptim të nenit 15 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

KGJK, më datën 24.10.2023, ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesën me numër ADGJTH.GJL.nr., për fillimin e hetimit disiplinor ndaj V. K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjiilan, me pretendim se i njëjti mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafët 2.15, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe neni 4, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Bazuar në faktet e prezantuara në kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor Autoriteti Kompetent ka konsideruar se subjekti i hetimit ka komunikuar në rrjetin social viber, me praktikanten e Gjykatës Themelore në Gjiilan E.Sh, ku në mesin e këtyre mesazheve ka kërkuar nga e njëjta që të flasë dhe të krijoj lidhje dashurie me djalin e tij. Ky komunikim sipas pretendimit të Autoritet Kompetent mund të jetë në kundërshtim me nenin 5, pika 1 dhe 2, nën pika 2.15, të Ligjit 06/L- 057, për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe neni 4, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjiilan, si Autoriteti Kompetent, më datë 26.09.2023, përmes Këshillit ka pranuar një parashtresë nga Prokuroria Themelore në Prizren, ku ish administratorja e kësaj gjykatë F.J, gjatë marrjes në pyetje për kallëzimin penal të saj, ka dorëzuar 15 faqe komunikim në mes të gjyqtarit në fjalë dhe praktikantes E.Sh nga Gj., si dhe komunikimet mes kësaj të fundit dhe ish administratores. Lidhur me këto pretendime, Autoriteti Kompetent ka kërkuar deklaratë nga subjekti i hetimit gjyqtarit V. K., i cili ka theksuar se pasi që e njëjta praktikante edhe

dy herë të tjera ka bërë deklaratat të tilla, të cilat janë mbyllur në mungesë të provave dhe për të cilat si subjekt hetimi ishte deklaruar, nuk e ka pa të arsyeshme që të deklarohet edhe një herë.

Pas grumbullimit të provave, përkatësisht komunikimit në mes të subjektit të hetimit gjyqtarit V. K. dhe praktikantes E.Sh, ku këto komunikime kanë munguar në dy rastet/rastet e lartë cekura, e që tash i janë bashkangjitur parashtresës së datës 25 shtator 2023, të pranuar nga Prokuroria Themelore në Prizren, Autoriteti Kompetent ka konsideruar se mund të ketë bazë për fillimin e hetimit disiplinor dhe bazuar në nenin 12, pika 2, lidhur me nenin 9, pika 1, nën pika 1.1 të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka kërkuar nga Këshilli themelimin e panelit hetimor.

Këshilli në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2023, ka themeluar panelin hetimor për të shërbyer në këtë rast disiplinor të evidentuar Nr.AD/KGJK/07/2023-GJTHGJL-AD.GJTH.GJL. nr...., i cili më datë 21.02.2024, i ka dorëzuar Këshillit, Raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura. Më datë 29.03.2024, Këshilli ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën ka prezantuar kryesuesja e panelit hetimor gjyqtarja Elvira Emini dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari V. K..

Në këtë seancë dëgjimore Kryesuesja e panelit deklaroi se si paneli kanë mbajtur seancë dëgjimore më datë 29.12.2023, në të cilën është dëgjuar subjekti i hetimit dhe ankuesja E.Sh. te paneli subjekti i hetimit ka deklaruar se nuk i pranon pretendimet e ngritura ndaj tij rreth kësaj çështje disiplinore, dhe ka theksuar se është e vërtetë se praktikantja E.Sh ka qenë si praktikante në zyrën e tij për 2 muaj. Sipas tij e njëjta praktikante edhe dy herë të tjera ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj tij, dhe se njërën ankesë e ka tërhequr vet dhe tjetrën kryetari i gjykatës e kishte mbyllur pasi nuk kishte gjetur fakte bindëse. Tutje, subjekti i hetimit te paneli kishte deklaruar se praktikantja E.Sh, ka qenë në lidhje me djalin e tij A. gjatë gjithë kohës sa janë zhvilluar këto komunikime dhe ka theksuar se kishte insistuar që t'i blej çantë duke qenë i sigurt që është në lidhje me djalin e tij. Sipas subjekti të hetimit lidhur me këtë çështje i gjithë problemi qëndron te ish administratorja e kësaj gjykate F.J, e cila sipas pretendimit të tij me qëllim që të dëmtoj atë ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prizren, dhe për këtë qëllim e ka shfrytëzuar si viktimë praktikanten E.Sh. Përfundimisht ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor lidhur me këtë çështje dhe ka kërkuar që të lirohet nga përgjegjësia disiplinore.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më datë 29.12. 2023, dëshmitarja E. Sh (ankuesja në këtë rast disiplinor) ka deklaruar se asnjëherë nuk ka qenë në lidhje me A. ( djalin e subjektit të hetimit

disiplinor gjyqtarit V.K.), dhe sipas ankueses gjyqtari V. K. kishte shkuar te familja e saj dhe ju kishte thënë se gjoja ajo ishte në lidhje me djalin e tij. Sipas ankueses E.Sh, në zyrën e gjyqtarit V. K., për të bërë praktikë është caktuar nga ish administratorja e gjykatës F.J dhe menjëherë pasi i kishte dhënë numrin e telefonit për të komunikuar për çështje pune, subjekti i hetimit ka filluar t'i shkruaj në viber, dhe po ashtu gjatë një udhëtimi i ka dërguar foto të disa çantave, të cilat ajo nuk kishte pranuar që të ia blej dhe vazhdimisht i kishte kërkuar që të takohet me djalin e tij.

Për t'i vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli administroi dhe vlerësoi këto prova: Raporti mbi faktet dhe provat e mbledhura; Kërkesa për fillimin e hetimeve disiplinore të KGJK-se, dhe atë AD/GJTH.GJL nr. ... të datë 20.10.2023, kundër gjyqtarit V. K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, e iniciuar nga autoriteti kompetent dhe atë Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Venhar Salihu; Njoftimi i datës 25.09.2023 nga Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda drejtuar Këshillit Gjyqësor të Kosovës-Kryesuesit, bashkangjitur me 15 faqe komunikim në rrjetin social viber, mes subjektit të hetimit dhe praktikantes E. Sh, dhe një pjesë e komunikimeve mes praktikantes dhe administratores së gjykatës F.J; Kërkesa e datës 05.10.2023 për dhënien e deklaratës sa i përket njoftimit të parashtruar nga PTH-Prizren për kallëzimin penal të ushtruar nga F. J, ndaj subjektit të hetimit; Deklarata e subjektit të hetimit e dhënë me dt. 16.10.2023; Njoftimi i datës 04.07.2023 nga ish Administratorja e Gjykatës Themelore në Gjilan znj. F.J, drejtuar Kryetarit të Gjykatës; Procesverbali i datës 28.04.2023 për grumbullimin e provave me rastin e emailit të datës 07.04.2023 dërguar nga ish. Administratorja e Gjykatës Themelore në Gjilan znj.F.J në lidhje me dëgjimin e praktikantes E. Sh; Procesverbali i datës 28.04.2023 për grumbullimin e provave me rastin e emailit të datës 07.04.2023 dërguar nga ish administratorja e gjykatës F.J, në lidhje me dëgjimin e dëshmitarëve Sh.D. dhe N.K; Procesverbali i datës 02.05.2023 për grumbullimin e provave me rastin e e-mail-it të datës 07.04.2023, dërguar nga ish administratorja e gjykatës F. J, në lidhje me dëgjimin e gjyqtarit V. K., Shënimi zyrtar i datës 03.05.2023 me shenjën AD.GJTHGJ.nr.... për mbylljen e rastit nga kryetari i kësaj gjykate; Deklarata e datës 14.10.2022 e dhënë nga administratorja e gjykatës F.J, dorëzuar kryetarit të gjykatës; Deklarata e praktikantes E. Sh, pa datë; Deklarata e gjyqtarit V. K. e datës 17.10.2022; Procesverbali i datës 17.10.2022 për dëgjimin e praktikantes E.Sh tek kryetari i kësaj gjykate, e cila e tërheq deklaratën; Shënimi zyrtar me shenjën AD.GJTHGJ.nr.... i datës 11.11.2022 nga kryetari i gjykatës për mbylljen e rastit; Komunikimet elektronike në rrjetin social viber mes subjektit të hetimit dhe praktikantes E. Sh, të printuara në 11 fletë, të dorëzuara nga subjekti i hetimit në seancë.

Këshilli bazuar në raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura konstatoi se autoriteti kompetent për dy rastet e para të paraqitjeve të ankesave disiplinore nga e njëjta ankuese për subjektin e njëjtë, në mungesë të fakteve bindëse njëra nga ankesat ishte mbyllur ndërsa ankesa tjetër është tërhequr nga vet ankuesja. Ndërsa, me parashtresën e pranuar nga Prokuroria Themelore në Prizren, të datës 25.09. shtator 2023, ishin bashkangjitur prova dhe fakte bindëse për autoritetin kompetent dhe ka kërkuar nga Këshilli fillimin e hetimit disiplinor.

Sipas vlerësimit të Këshillit, zhvillimi i komunikimit në rrjetin social në viber në mes të subjektit të hetimit dhe praktikantes E.Sh është komunikim jashtë etikës së gjyqtarëve në raport me stafin e gjykatës dhe me këtë sjellje subjekti i hetimit ka shkelur edhe neni 4, të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Gjyqtar.

Tutje, Këshilli vlerësoj se subjekti i hetimit në këtë rast nuk është dashur të përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit. E posaçërisht në asnjë rrethanë nuk duhet të shfrytëzojë pozitën e tij gjyqësore, as t'i lejojë të tjerët që ta shfrytëzojnë pozitën e tij për interesa private. Gjyqtari duhet të sillet në mënyrë të nderhme, të dinjiteteshme dhe duhet të jetë gjatë tërë kohës në harmoni me karakterin e lartë moral, i cili është thelbësor për ruajtjen e reputacionit të gjyqësorit. Gjyqtari është dashur të sillet me integritet, si në jetën profesionale ashtu edhe në jetën personale, dhe nuk duhet të përdorë gjuhën e urrejtjes apo të ketë sjellje të pahijshme apo të vrazhdë. Në këtë rast gjyqtari nuk ka vepruar në këtë mënyrë, por ka zgjedh një rrugë tjetër e cila është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe Kodin e Etikës për Gjyqtarë. Këshilli bazuar në nenin 12.2 lidhur me nenin 9.1, nën pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, vlerëson se komunikimi në mes të gjyqtarit dhe praktikantes së lartcekur është në kundërshtim me nenin 5-shkelje disiplinore për gjyqtar, pika 2-shkelje të detyrave të gjyqtarit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në çoftë se gjyqtari i kryen me dashje as nga pakujdesia e rëndë, nën pika 2.15-përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 4 të Kodit të Etikës për Gjyqtarë. Përgjegjësitë e gjyqtarit që lidhen me sjelljen e tij si dhe në promovimin e besimit të publikut ndaj gjyqësorit rrjedhin nga dispozitat e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar. I njëjti

Kod sqaron se gjyqtari duhet të ruaj dhe promovojë integritetin e figurës se gjyqtarit dhe që në rastin konkret vlerësohet se gjyqtari K. me sjelljen e tij ka konsumuar të gjitha elementet e shkeljeve etike.

Shkeljet e sipër theksuara janë provuar me provat e administruara, të cilat i janë prezantuar Këshillit nga raporti fakt mbledhës të panelit hetimor. Këshilli ka gjetur se subjekti i hetimit gjyqtari V. K. është përfshirë në shkelje disiplinore të rëndë siç ka pretenduar Autoriteti Kompetent dhe i shqiptoi sanksionin disiplinor; "zvogëlimi përkohshëm i pagës për 30 % për periudhën kohore për gjashtë (6) muaj", duke menduar se është masë proporcionale me shkeljen e konsumuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar është i ligjshëm dhe është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale kur është vërtetuar përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit V. B. për shkeljen e Kodit të Etikës, konkretisht nenit 5, paragrafi 2 pika 2.15 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me qëndrimin se shkeljet e sipër theksuara janë provuar gjatë administrimit të provave, të cilat i janë prezantuar Këshillit, nga raporti fakt mbledhës i Panelit Hetimor i cili është vlerësuar si raport i besueshëm pasi që në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore Paneli ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve. Siç del nga shkresat e lëndës, Këshilli i ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, por ka gjetur se në kuptim të fakteve të konstatuara me provat e administruara këto pretendime dhe deklarata nuk kanë ndikuar që Këshilli të marr një vendim tjetër. Ky qëndrim i KGJK-së u miratua edhe nga kjo gjykatë për faktin se procedura dhe masa e shqiptuar janë në pajtim me ligjin.

Pretendimi ankimor për cenim të drejtës në mbrojtje nuk u argumentua me asnjë provë. KGJK në pajtim me ligjin ka formuar panelin hetimor për të shqyrtuar pretendimet e autoritetit kompetent. Paneli ka zhvilluar hetim në përputhje me ligjin dhe ka administruar procesin duke i dhënë mundësi deklarami subjektit hetimor për përgjigje në çdo pretendim. Këshilli më datë 8 dhe 15.09.2021, ka mbajtur seanca dëgjimore, pas pranimit të Raportit nga Paneli Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore. Në pajtim me ligjin është zhvilluar hetimi dhe mbi bazën e këtij hetimi KGJK ka shqiptuar masën disiplinore si në dispozitivin e vendimit të atakuar me ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon edhe qëndrimin se masa disiplinore e shqiptuar është proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit dhe është në zbatimin e përgjegjësive ligjore që ka Këshilli Gjyqësor në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Gjykata Supreme gjeti se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 15 të Ligjit që rregullojnë çështjen e ankimit ndaj vendimeve të KGJK-së, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pika 4 e këtij neni parasheh se ankesa ndaj vendimeve të Këshillit mund të ushtrohet në rast të zbatimit të gabuar të Ligjit (4.1) dhe në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës (4.3).

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e KGJK-së, lidhur me pretendimin e subjektit të hetimit se ankuesja E. Sh është shtrënguar nga ish administratorja për të bërë ankesë disiplinore ndaj tij, nuk qëndron, sepse ajo deklaroi se ankesën e ka bërë me vet iniciativë dhe nga ish administratorja e gjykatës kishte kërkuar që të ia ndërronte zyrën dhe ta caktoj të një gjyqtar tjetër sepse ia kishte bërë të pa mundur vazhdimin e praktikës në zyrën e tij.

Ndërsa lidhur me atë se pse e kishte tërhequr ankesën e parë disiplinore ndaj subjektit të hetimit, e njëjta është deklaruar që këtë e ka bërë që të mos e kupton familja e saj. Ndërsa e pyetur nga paneli se pse pasi e ke tërhequr njëherë deklaratën ndaj gjyqtarit, prapë e ke aktivizuar këtë çështje, e njëjta ka shtuar se herën e parë në gjykatë si praktikante ka qenë me projekt për 4 muaj, ndërsa për herën e dytë ka filluar praktiken në muajin mars të 2023-es, për periudhën 1 vjeçare. Gjatë qëndrimit si praktikante për herën e dytë, në zyrën e ekzekutimit, subjekti i hetimit kishte shkuar dhe i kishte thënë, "ti ma ke qit fytyrën e zezë mua, unë e kam përjashtuar administratoren", dhe për këtë situatë ishte ndier keq sepse ka qenë në prezencën edhe të kolegëve. Për shkak të këtij presioni nga subjekti i hetimit i është dashtë ta ndërroj numrin e telefonit dhe më këtë rast ka vendosur ta paraqes ankesën disiplinore ndaj tij.

Subjekti i hetimit, gjyqtari V. K. e ka pranuar komunikimin me ankuesen përmes rrjetit viber por ka deklaruar se e ka konsideruar si anëtare të ardhshme të familjes së saj, duke i ofruar dhurata dhe thurur komplimente si nuses së ardhme të djalit të tij. Nga na tjetër ankuesja e mohon lidhjen midis saj dhe djalit të gjyqtarit dhe deklaroi se komunikimi i subjektit hetimor kalon kufijtë e punës dhe të raportit të ndërsjellë gjyqtarë- staf.

Bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Vendimit të KGJK-së, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa e subjektit hetimor, e ushtruar ndaj vendimit të KGJK-së nuk mbështetet në fakte. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka dëshmuar se është bërë shkelje disiplinore nga parashtuesi i ankesës, i ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe ka marrë parasysh edhe seriozitetin, pasojat, rrethanat në të cilat është kryer shkelja. Prandaj pretendimet e ankesës për aplikim të gabuar të së drejtës materiale janë të pa bazuara dhe si të tilla u refuzuan.

Pretendimi ankimor se vendimi i KGJK-së është marr nën presionin e opinionit publik, nuk provua dhe se në procedurë me fakte është provuar shkelja e cila i ngarkohet gjyqtarit dhe për më tepër KGJK kishte pas para sysh edhe faktin se ndaj subjektit të hetimit ende është aktive sanksioni disiplinorë "vërejtje publike me shkrim", i shqiptuar me datë 14 dhjetor 2022.

Pretendimi ankimor se arsyetimi i vendimit është kundërtëhënës dhe njëherit paraqet zbatim të gabuar të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës Profesionale, nuk u mbështet me asnjë fakt dhe është i pa qëndrueshëm konstatimi se KGJK nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare duke theksuar vetëm faktet dhe vlerësimet por pa i arsyetuar ato. Për më tepër pretendimi ankimor se Gjyqtari në rastin e bisedës nuk ka sjellje të pa hijshme sepse e ka konsideruar ankuesen si anëtare të familjes, është konstatim i pasaktë dhe nuk mbështetet në ligj sepse në arsyetimin e Vendimit nga KGJK me të cilin pajtohet edhe Gjykata Supreme e Kosovës me të drejtë thuhet sipas dispozitës së nenit 2.15 përcaktohet se “përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit” del qartazi se gjyqtari, subjekt i hetimit e ka konsumuar shkeljen për të cilën ngarkohet dhe se kjo shkelja është e paraparë në përputhje me nenit 5.2.15, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili parasheh se Gjyqtari kryen shkelje disiplinorë nëse përfshihet në sjellje, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit" dhe sanksioni disiplinor është në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 2, nen paragrafët 1,2 dhe 5; të njëjtit ligj i cili parasheh edhe sanksionin disiplinor.

Prandaj sipas Gjykatës Supreme të Kosovës është zbatuar procedura e paraparë sipas ligjit në fuqi dhe masa e dhënë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh:



seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtari, pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; Ky sanksion disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor ashtu siç parashihen në nenin 7 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Prandaj, pretendimet në ankesë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan asnjërën nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa dhe nuk kanë bazë në nenin 15, pika 4.1 deri pika 4.3 të Ligjit, gjegjësisht nuk u gjet zbatim i gabuar i ligjit, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga sa u tha në ankesë e në pajtim me nenin 15.6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.19/2024, më 24.05.2024.

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami